

GJYKATA KOMUNALE PER KUNDERVAJTJE NE PRIZREN, me gjykatesen Vjollca Buzhalen e me procesmbajtesen Firdeze Santurin, ne proceduren kundervajttese kunder te pandehures Bajrame Tafallari nga Prizreni , per shkak te kundervajtjes nga neni 5,6 par. 1 p.3 sanksionuar ne baze te nenti 17 par 1 p.3 te Ligjit per deklarimin prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtareve te larte publik dhe deklarimin , prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave per të gjithë personat zyrtare, e ne baze te nenit 195 te LMK-se me dt.17.09.2012 mori kete

A K T V E N D I M

PEZULLOHET procedura kundervajttese kunder te pandehurës Bajrame Tafallari nga Prizreni , per shkak te kundervajtjes nga neni 5,6 par. 1 p.3 sanksionuar ne baze te nenti 17 par 1 p.3 te Ligjit per deklarimin prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtareve te larte publik dhe deklarimin , prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave per të gjithë personat zyrtare,

-konform nenit 198 al.1 p.8 te LMK-se pasi qe nuk ka prova se e padenura ka kryer kundervajtjen.

Shpenzimet e procedures kundervajttese bijne ne bare te mjeteve buxhetore te kesaj gjykate

A r s y e t I m

Sipas kerkeses se AgjendSIONIT antikorupcion në Prishtinë , me nr 01-1906/2012 të dt. 24.05.2012 eshte ngritur procedura kundervajttese kunder te pandehures Bajrame Tafallari nga Prizreni, per shkak te kundervajtjes se lartecekur ne dispozitiv te aktvendimit.

E pandehura ne seancen verbale te mbajtur me dt.05.07.2012 ka theksuar se eshte e vertete se ne afatin ligjor derim me t 31.03.2012 nuk kam bere deklarimin e pasurise por arsyeja qendron ne ate se unë afër 8 – 9 muaj jam ne trajtim mjeksor , kam qene dhe ne spital , keshtu qe ne Asamble Komunale per here te pare jam paraqitur ne muajin Prill dhe me vonese kam mare formularin per deklarim te pasurise. Si prove materijale gjkyates ia deponoj dokumentacionin e mjekut fletesleshimin e spitalin si dhe do tju sjelle vertetimin nga Asambleja ku do te shihet se une per heret e pare ne Asamble jam paraqitur ne muajim Prill.

Gjykata me qellim te vertetimit te drejte te gjendjes faktike ka kerkuar nga perfaqesusi I Kuvendit komunal- personi kompetent per njfotimin e Asambleistëve me formular per deklarimin e pasurise ku nga I njëjti është sjellur vertetimi me te cilin vertetohet se Bajrame Tafallari ne bazë rezultateve te dala ne votimet e mbajtura ne nentor të viti 2009 është zgjedhur anëtare prane Kuvendit te Komunes se Prizrenit e që është edhe deri me ditët e sotme , por që qe nga data 27 Tetor e viti 2011 gjer me dt. 27. Prill 2012 nuk ka mare pjese ne seancat e ftuara te Kuvendit pasi

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT	
AGENCIA PROTIV KORUPCIE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	DPK / DMP
Nr. Prot. Br. Prot. Prot No.	03-3421/12
Data Datum Date	26.09.2012
	02

13.09.2012
Rrethi

qe e njejta ka patur problem shendetsore dhe nuk ka qene e njfotoaur por formularin per mosdeklarim te pasurise..

Andaj ne mungese te provave gjykata ka pezulluar proceduren kundervajtese ndaj te pandehurit per shkak te kundervajtjes se lartecekur ne dispozitiv te ketij aktvendimit. e ne kuptim te nenit 198 al.1 p.8 te LMK_se.

Nga sa u tha me larte u vendos si ne dispzitiv te ketij aktvenimi.

GJYKATA KOMUNALE PER KUNDERVAJTJE NE PRIZREN

Nr.491/2012-05

dt.17.09.2012

Procesmbajtesja

Gjykatesi per kundervajtje

Erdeze Santuri

Vjollca Buzhala

UDIEZIMI JURIDIK:Kunder ketij aktvendimi e ne afat prej 8 ditesh mund te ushtrohet ankese Gjykates se Larte per kundervajtje ne Prishtine, nepermes kesaj gjykata pa taksa.